



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E
TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E MBIKËQYRJES NË FUSHËN E DREJTËSISË PENALE DHE
SIGURISË PUBLIKE

Nr. 2414/6 prot.

Tiranë, më 26.12.2024

REKOMANDIM

Nr. 37, datë 26.12.2024

PËR KONTROLLUESIN

QENDRA “TË NDRYSHËM & TË BARABARTË” (D&E)

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), si dhe provave të administruara në ngarkim të Kontrolluesit “Qendra “Të Ndryshëm dhe të Barabartë” (D&E)” (në vijim, “Kontrolluesi ose Qendra “D&E””),

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 196, datë 14.11.2024 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), u krye hetimi administrativ pranë Kontrolluesit, me objekt:

- *Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.*

Komisioneri, pasi shqyrtoi procesverbalin e konstatimit, provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, si dhe relacionin e hetimit administrativ, vëren se:

1. Qendra “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (D&E) është person juridik jopublik, i regjistruar në regjistrin e OJF-ve, me Vendimin nr. 177, datë 17.05.2004, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Kontrolluesi ushtron veprimtarinë e tij, si organizatë jofitimprurëse, e cila ofron shërbime të kualifikuara psikologjike dhe sociale për mbrojtjen dhe ri-integrimin e viktimave të trafikimit, si dhe kontribuon në sistemet e identifikimit, referimit, sensibilizimit, parandalimit dhe ndihmës ndaj këtij grupi dhe grupeve të tjera, në rrezik trafikimi apo stigmatizimi, si efekt i migrimit.

2. Bazuar në ligjin nr. 121/2016 *“Për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”*, VKM nr. 582, datë 27.07.2011 *“Për miratimin e Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/viktimave të Mundshme të Trafikimit”*, VKM nr. 658, datë 17.10.2005 *“Për standardet e shërbimeve shoqërore”*, VKM nr. 195, datë 11.04.2007 *“Për miratimin e standardeve të shërbimeve të përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”*, Kodi i Punës e aktet nënligjore në zbatim të tij, si dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kontrolluesi legjitimohet të përpunojë të dhënat personale të Viktimave të Trafikimit dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, të identifikuar me termin *“Përfitues”*.

Kontrolluesi, në funksion të veprimtarisë së tij, përpunon të dhëna personale, pjesë të dosjeve të përfituesve nga programet dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror, në qendrat rezidenciale, për përfituesit. Qendra “D & E” përpunon të dhëna personale, lidhur me: *“Të dhënat e identifikimit”*, *“Të dhëna biometrike”*, *“Adresa”*, *“Numri i sigurimit shoqëror”*, *“Diploma, certifikata”*, *“Foto”*, *“Të dhëna ekonomike dhe financiare”*, *“Imazhe nëpërmjet sistemit CCTV”*, si dhe të dhëna sensitive, për kategoritë: *“shëndeti”*, *“rraca/etnia”*, *“gjendja penale”* dhe *“jeta seksuale”*.

Përpunimi i të dhënave kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike të administruara në format *“excel”*.

3. Kontrolluesi disponon rregullore *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*. Referuar gurmës *“a”*, të nenit 4 *“Përkufizime”*, të rregullores *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, konstatohet se, Qendra përcakton si *“Kontrollues”*, të gjithë punonjësit e *“D&E”*, përfshirë bashkëpunëtorët dhe vullnetarët.

Zyra e Komisionerit, bën me dije se, referuar pikës 5, të nenit 3, të Ligjit, *“Kontrollues”*, nuk janë punonjësit e *“D&E”*, duke përfshirë bashkëpunëtorët dhe vullnetarët, por është vetë Qendra *“D&E”*, personi juridik në rolin e Kontrolluesit, i cili përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, si dhe përgjigjet për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në Ligj e në aktet e tjera nënligjore.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla specifike mbi përcaktimin e roleve dhe nivelet e aksesit në të dhënat personale në përputhje me detyrat funksionale të çdo punonjësi, referuar

pozicionit të punës, si një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, për të mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

4. Nga analizimi i rregullores “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, rezulton se, në pikën 9, të nenit 19, përcaktohet se periudha e ruajtjes së dokumentacionit shkresor, në përmbajtje të të cilit, gjenden edhe të dhëna personale të subjekteve të të dhënave që dalin jashtë programit të ri-integrimit, është 5 vjet nga dita e daljes nga ky program.

Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar në ambientet e Kontrolluesit dhe nga provat e administruara, lidhur me përpunimin e këtyre të dhënave, konstatohet se kartelat shëndetësore të përfituesve administrohen përtej afatit 5 vjeçar (dokumentacioni i viteve 2016 dhe 2018), pa argumentuar dhe dokumentuar nevojën për administrimin e tyre, tej afatit të përcaktuar.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka marrë masa konkrete dhe afatgjata, duke patur në vëmendje rëndësinë e garantimit të sigurisë së informacionit, aksesin e kufizuar e të autorizuar, mbajtjen e dokumentacionit për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin për të cilin është grumbulluar, si dhe nuk ka respektuar afatet e sipërpërmendura, në kundërshtim me parashikimet e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5, të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me kategoritë e të dhënave të grumbulluara, në funksion të ushtrimit të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi duhet të parashikojë mbajtjen e të dhënave personale në atë formë, që lejon identifikimin për një kohë të caktuar, por jo më tepër se sa është e nevojshme për të përmbushur qëllimin për të cilin të dhënat janë grumbulluar.

Koha e ruajtjes së të dhënave personale duhet të përcaktohet nga Kontrolluesi, në përputhje me parashikimin e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5, të Ligjit.

5. Gjatë hetimit administrativ të zhvilluar, pranë ambienteve ku Kontrolluesi ushtron veprimtarinë, rezulton se, ky i fundit disponon sistem video survejimi CCTV, i cili përbëhet nga 4 kamera, të vendosura në ambientet e jashtme, për qëllim të mbrojtjes së pronës dhe jetës, si dhe sigurimin e kontrollit mbi hyrjet dhe daljet nga ambientet e Qendrës “D&E”.

Gjithashtu, është konstatuar se Kontrolluesi nuk ka vendosur tabelat informuese në të gjithë ambientet e survejuara nëpërmjet sistemit CCTV, sipas modelit standard të Komisionerit, me anë të të cilave, informohen subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 3, datë 05.03.2010 të Komisionerit “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”, i ndryshuar (në vijim, “Udhëzimi nr. 3”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, një nga mjetet e rëndësishme të përpunimit të të dhënave personale është edhe sistemi i video survejimit CCTV. Të dhënat e ruajtura në këto sisteme, si: “imazhe”, “video” janë të dhëna personale dhe përpunimi i tyre duhet të jetë në përputhje me parashikimet e Ligjit, si dhe aktet e miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga Kontrolluesi.

Për më tepër, informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video survejimit CCTV, është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit, pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale, të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mospërbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

6. Kontrolluesi ka nënshkruar një kontratë me z. Ilir Spahiu, Person Fizik, me objekt: *“Kryerjen e Shërbimit IT për kompjuterat e organizatës “Të ndryshëm & të Barabartë”*”.

Nga shqyrtimi i përmbajtjes së kontratës së mësipërme, rezulton se nuk janë reflektuar detyrimet, sipas parashikimit në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, datë 03.08.2012 të Komisionerit *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”*, i ndryshuar (në vijim, *“Udhëzimi nr. 19”*).

Zyra e Komisionerit vlerëson se, të gjitha detyrimet e sanksionuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 19, duhet të jenë të përfshira në kontratën dhe/ose aneks kontratën e hartuar dhe nënshkruar mes kontrolluesit dhe përpunuesit. Çdo kontratë përpunimi, që ka për qëllim delegimin e përpunimit të të dhënave personale duhet të përmbajë dispozita që vendosin rregulla për përpunimin e të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi. Çdo kontratë e tillë duhet të parashikojë masat që duhet të marrë përpunuesi për të siguruar dhe garantuar mbrojtjen e mjaftueshme të të dhënave, si dhe hapat që do të ndërmerren në rast cenimi të të dhënave, me qëllim që të sigurojë paprekshmërinë e tyre, në çdo hallkë të këtij përpunimi.

7. Referuar germave “a” dhe “b”, të pikës së dytë, të nenit 12 *“Masat për sigurinë e të dhënave”*, të rregullores *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, konstatohet se mënyra e përcaktimit të funksioneve dhe përdorimit të të dhënave personale, kryhet me urdhër të njësive organizative ose të operatorëve të autorizuar.

Nga analizimi në tërësi i rregullores *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, si dhe provave të mbledhura gjatë hetimit administrativ, konstatohet se Kontrolluesi nuk arrin të dokumentojë këtë mënyrë të

përcaktimit të funksioneve dhe të drejtave të aksesit mbi të dhënat personale dhe sensitive, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi, në rregulloren “Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, parashikon rregulla të përgjithshme dhe jo direkt të aplikueshme, lidhur me proceset përpunuese që kryen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, duke mos parashikuar në të, rregulla dhe procedura organizative specifike mbi nivelet e aksesit në të dhënat personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit, datë 05.08.2012 “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale” (në vijim, “Vendimi nr. 6”).

Për këtë arsye, Zyra e Komisionerit vlerëson se, është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë së të dhënave, nivelet e aksesit në të dhënat personale, sipas proceseve përpunuese (konkretisht, në nenin 12 “Masat për sigurinë e të dhënave”), ku përshkruhen procese përpunimi të të dhënave, të cilat nuk gjejnë zbatim konkret në objektin e aktivitetit të Kontrolluesit), në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Vendimit nr. 6 të Komisionerit.

8. Të miturit, si shoqërues të subjektit përfitues, që trajtohen nga Kontrolluesi (*foshnjat e lindura nga viktimat e trafikimit/viktimat e mundshme të trafikimit*), nuk identifikohen në rregullore, si dhe për këtë kategori subjektsh të të dhënave personale nuk janë hartuar rregulla dhe procedura organizative specifike, mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, nivelet e aksesit etj., si një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, pasi shmang pasojat e rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Të dhënat e administruara nëpërmjet kartelave dhe çdo dokumentacioni tjetër shëndetësor, ruhen në ambientet e zyrës së arkivit, duke mos marrë, midis të tjerash, masa organizative dhe fizike, si një kategori e veçantë, të cilës duhet t’i sigurohet mbrojtje e dyfishtë dhe vëmendje e shtuar për të garantuar mbrojtjen dhe sigurinë e tyre, në përputhje me nenin 27 të Ligjit, si dhe nenit 5 dhe 8 të Udhëzimit nr. 49 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se Kontrolluesi është i detyruar të marrë masa sigurie, sipas nenit të 27 Ligjit, për mbrojtjen e të dhënave personale të foshnjeve dhe përfituesve, duke i kushtuar vëmendje të veçantë të dhënave sensitive. Kontrolluesi duhet të hartojë rregulla dhe procedura organizative specifike për këtë kategori të të dhënave personale, në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e këtyre të dhënave. Të dhënat sensitive duhet të administrohen në mënyrë të tillë që të garantohet se, përpunimi i tyre i nënshtrohet masave teknike dhe organizative të posaçme, të dedikuara dhe të rishikuara rregullisht, në përputhje me nenin 27 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 49 të Komisionerit.

9. Në ambientet e Kontrolluesit, konstatohet se nuk është ndërmarrë asnjë masë sigurie lidhur me ruajtjen e ambienteve fizike, si masë shtesë teknike dhe organizative për të dhënat personale dhe të dhënat sensitive, të administruara gjatë ushtrimit të veprimtarisë, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit.

Për rrjedhojë, Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi nuk ka marrë masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit, datë 14.09.2018 “*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*” (në vijim, “*Udhëzimi nr. 47*”).

Gjithashtu, Zyra e Komisionerit vlerëson se, niveli i sigurisë së ambienteve fizike duhet të jetë i përshtatshëm me natyrën e përpunimit dhe kategoritë e të dhënave personale dhe sensitive, të cilat përpunohen nga Qendra “D&E”.

10. Kontrolluesi ka vendosur në dispozicion të grupit të hetimit administrativ, “*Politikat e Sigurisë Për Organizatën Të Ndryshëm & Të Barabartë*”. Gjatë analizimit të këtij akti, konkretisht në pikën 3.8, përcaktohet se: “*D&E*” do të ndërmarrë vlerësime mbrojtëse të rrezikut për të identifikuar fushat e sigurisë dhe mbrojtjes nga çdo lloj shkelje të të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor”.

Nga analizimi i provës së mësipërme dhe provave në tërësi, rezulton se, Kontrolluesi nuk ka kryer Analizën e Riskut, për proceset përpunuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë, me qëllim evidentimin e rasteve që mund të çenojnë konfidencialitetin, integritetin, disponueshmërinë e të dhënave personale dhe shkallën e riskut të mundshëm, si dhe propozimet e masave për eliminimin apo minimizimin e ndikimit të riskut, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, është e domosdoshme që Qendra “D & E”, të hartojë një Analizë Risku, që të përmbajë një vlerësim të plotë dhe të detajuar të rreziqeve që mund të ndodhin gjatë procesit të përpunimit të të dhënave, duke identifikuar çfarë mund të çenojë të drejtat e subjekteve të të dhënave, në veçanti në lidhje me sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.

Sa më sipër, vlerësohet se, Kontrolluesi është në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

11. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete për trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, lidhur me legjislacionin shqiptar në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, në kundërshtim me parashikimet e nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimit nr. 47 të Komisionerit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, bazuar në Kreun IV, të Udhëzimit nr. 47, Kontrolluesi duhet të marrë masa konkrete për trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, bazuar në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Trajnimet në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, duhet të jenë të vazhdueshme dhe të përshtatura, sipas nevojave dhe proceseve të punës të Kontrolluesit dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve, të cilët për shkak të proceseve të punës, janë të ngarkuar për përpunimin e të dhënave personale.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i hetimit administrativ hartoi procesverbalin përkatës, një kopje e të cilit i është dërguar zyrtarisht Kontrolluesit me rrugë postare.

Në zbatim të neneve 87-89 të Kodit të Procedurave Administrative, Kontrolluesit i është lënë afat të depozitohet pretendimet me shkrim, referuar procesverbalit të hartuar nga ana e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar nga ana e Komisionerit.

Përmes shkresës nr. 73 prot., datë 18.12.2024, administruar me tonën nr. 2414/5 prot., datë 18.12.2024, Qendra “D & E”, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit, pretendimet lidhur me procesverbalin e hetimit administrativ.

- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dërguar, rezulton se Kontrolluesi nuk ka depozituar dokumentacion shtesë provues, në lidhje me konstatimet e procesverbalit. Gjithashtu, nga përmbajtja e pretendimeve, rezulton se Qendra “D & E”, nuk i ka të qarta detyrimet e parashikuara në Ligj (*roli i Kontrolluesit, nivelet e aksesit, përcaktimi i afateve konkrete për çdo proces përpunimi në dokumentacion shkresor dhe elektronik, trajnimi i vazhdueshëm dhe konsistent për mbrojtjen e të dhënave personale, si dhe marrja e masave teknike e organizative lidhur me sigurinë e të dhënave, përfshirë zbatimin e tyre në praktikë*). Megjithatë, Zyra e Komisionerit ka analizuar gjithë dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Qendra “D & E”, duke argumentuar sipas gjetjeve të sipërcituara në pikat 1-11 të këtij Rekomandimi, vlerësimin përkatës, në përputhje me verifikimet e bëra në terren dhe detyrimet e përcaktuara në Ligj.
- Për sa i përket pretendimeve mbi administrimin e dosjeve mjekësore, Zyra e Komisionerit vlerëson se, lidhur me përpunimin e të dhënave sensitive që lidhen me gjendjen shëndetësore, Kontrolluesi duhet t’i referohet parimeve të mbrojtjes së të dhënave personale, si dhe Udhëzimit nr. 49 të Komisionerit, për mënyrën e mbajtjes dhe administrimit të tyre, duke garantuar kështu, mbrojtje të dyfishtë dhe vëmendje të shtuar, krahas të dhënave të tjera personale të përfituesve (pika 8 e këtij Vendimi).

Në përfundim të hetimit administrativ, Zyra e Komisionerit ka vlerësuar bashkëpunimin e Kontrolluesit me grupin e kontrollit gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, si dhe angazhimin e tij për të rikuperuar disa nga shkeljet e konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 5, 18, 20, 27, 29, 30, 31 (pika 1, germa “a/1”), si dhe 32 të Ligjit,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi, të marrë masa për mbajtjen e dokumentacionit për aq kohë sa është i nevojshëm, për qëllimin për të cilin është grumbulluar duke respektuar afatet e përcaktuara, në përputhje me parashikimet e germës “d”, të pikës 1, të nenit 5, të Ligjit. Gjithashtu, Kontrolluesi, të marrë masa për përcaktimin e afateve kohore për ruajtjen e të dhënave personale, referuar çdo procesi përpunimi të të dhënave personale.
2. Kontrolluesi, të marrë masa për vendosjen e tabelave informuese në ambientet e survejuara përmes sistemit CCTV, sipas modelit standard të miratuar në Udhëzimin nr. 3 të Komisionerit, me qëllim informimin e plotë të subjekteve të të dhënave, sipas parashikimeve të nenit 18 të Ligjit;
3. Kontrolluesi, të përfshijë në kontratën dhe/ose aneks kontratën e shkruar mes Kontrolluesit dhe Përpunuesit, detyrimet për përcaktimin e rregullave specifike në lidhje me marrëdhënien mes palëve, në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave, sipas dispozitave të parashikuara në nenin 20 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 19 të Komisionerit;
4. Kontrolluesi, të marrë masa për rishikimin në *“Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, të masave konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të dhënave sensitive, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, garantimin e konfidencialitetit, niveli i aksesit etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit.
 - Gjithashtu, Kontrolluesi të marrë masa për vendosjen e rregullave të posaçme për mbrojtjen e të dhënave personale e sensitive të foshnjeve dhe Viktimave të Trafikimit/Viktimat e Mundshme të Trafikimit, në lidhje me mënyrën e përpunimit dhe sigurinë e këtyre të dhënave, në përputhje me nenin 27 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 49 të Komisionerit;
5. Kontrolluesi, të marrë masa për hartimin e Analizës së Riskut, gjatë ushtrimit të veprimtarisë, me qëllim evidentimin e rasteve që mund të çenojnë konfidencialitetin, integritetin dhe disponueshmërinë e të dhënave personale, sipas parashikimeve të nenit 27 të Ligjit dhe Udhëzimin nr. 47 të Komisionerit;
6. Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale, duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me trajnimin e

punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, në përputhje me proceset përpunuese që ata kryejnë gjatë veprimtarisë së tyre;

7. Në zbatim të pikës 1, të nenit 32 të Ligjit, të përmbushen detyrimet, sipas këtij akti brenda afateve, si vijon:

- (i) vazhdimisht, detyrimet e treguara në pikën 1 dhe 6 më sipër;
- (ii) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimin e treguar në pikën 2 më sipër;
- (iii) brenda 30 (tridhjetë) ditëve, detyrimet e treguara në pikat 3 dhe 4 më sipër;
- (iv) brenda një viti kalendarik, detyrimin e treguar në pikën 5 më sipër;

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti;

9. Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra;

10. Në rast mospërmbushje të detyrimeve të parashikuara në këtë akt, Komisioneri vepron sipas pikës 2, të nenit 30 dhe nenit 39 të Ligjit, të cilët parashikojnë se në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të Ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, Komisioneri vendos sanksione administrative për kundërvajtjet administrative përkatëse dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot, më 26.12.2024.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi